



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 263/24 Dt. 22.04.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Zyrës për Komunitete dhe Kthim, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e furnizimit me 1065 m³ lëndë djegëse-dru zjarri për rastet sociale dhe skamnore të komunitetit minoritar, kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Përfitues të këtij projekti me nga 3 m³ lëndë djegëse-dru për një familje do jenë:
 - 2.1. Nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.....100 familje,
 - 2.2. Nga komuniteti turk..... 100 familje,
 - 2.3. Nga komuniteti boshnjak..... 100 familje,
 - 2.4. Nga komuniteti serb..... 55 familje.
3. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor dhe subvencione dhe transfere të Zyrës së Kryetarit të Komunës.
4. Obligohet Zyra për Komunitete dhe Kthim, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Zyrës për Komunitete dhe Kthim,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit i Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.

